

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju bëjmë me dije se:

TV Channel 7; TV 6+1; One TV Vlora dhe TV Glob nuk kanë depozituar në AMA më datë 06.04.2021 regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të një dite më parë. (TV Kukësi ka depozituar materiale të regjistruara të paplota).

AMA rikujton këto subjekte, por dhe të tjera, të njoftuara nga AMA në mënyrë të përsëritur, me shkresë zyrtare dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta, se duhet që të zbatojnë sistematikisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ. Përmbajtjet e regjistruara duhet të depozitohen në AMA brenda orës 10:00 të ditës së nesërme të transmetimit.

Gjithashtu dhe OSHMA-të: Shijak TV; Ora News; Top News; Klan Plus; dhe Kanali 7, kanë marrë njoftim të përsëritur se duhet të depozitohen në AMA regjistrimet e datës 03.04.2021 (nga ora 13:00 deri më 24:00), si dhe më datë 04.04.2021 (nga ora 08:00 deri më 11:00).

Kanë transmetuar reklama politike brenda edicioneve të lajmeve OSHMA-të:

TV Klan News	15:09; 15:14; 15:15; 15:19; 15:25; 16:30; 16:32; 16:32; 16:39; 16:49; 16:53; 17:06; 17:08; 21:04; 21:05; 21:13; 21:5; 21:52; 22:15; 22:16; 22:21; 22:43; 22:44; 23:11; 23:34 dhe 23:40
TV 6+1	Në edicionet e lajmeve të orës 17:00;19:00 dhe 21:30
TV Apollon	18.59

Kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

TV Shijak	09:56; 11:26; 14:27; 19:58 dhe 20.38
TV 6+1	08:35; 08:36; 08:37; 08:39; 08:40; 08:41; 08:42; 08:44; 08:46; 08:47; 09:48; 09:50; 09:51; 09:52; 09:54; 09:55; 09:56; 09:57; 11:05; 11:06; 11:07; 11:09; 11:11; 11:13; 11:14; 13:52; 13:53; 13:54; 13:56; 13:58; 13:59; 14:18; 14:19; 4:20; 14:21; 14:22; 14:23; 14:24; 19:59; 20:02; 20:03; 20:05; 20:06 dhe 20:07
One TV Vlora	08:40; 08:50; 09:22; 09:54; 11:17; 12:36; 12:44; 13:42 dhe 20:48
TV Apollon	09:57; 11:58 dhe 18.59

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet e monitorimit për OSHMA-të e përfshira në monitorim për datën 05.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 06.04.2021